

Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Unë jam në këtë sallë si përfaqësuese e qarkut të Fierit, e bashkisë së Divjakës, më konkretisht edhe e njerëzve të saj punëtorë, të cilët kanë ngarkuar mbi mua barrën e përgjegjësisë për t'i përfaqësuar. Divjaka e bekuar me detin, lagunën, parkun, tokat me prodhimtari të lartë, njerëzit punëtorë që djersijnë çdo ditë arave, duhet të ishte sot në fakt e mbushur me jetë, me gumëzhima fëmijësh në parqe e shkolla dhe me të rinj. E vërteta është që sot po kërruset ditaditës. Të rinj që largohen pa e kthyer kokën pas, që largohen nga papunësia, nga mungesa e sigurisë për të nesërmen, nga mungesa e sigurisë që prodhimet e tyre do të shiten. Shkollat kanë numër të reduktuar nxënësish nga viti në vit. Ata që jetojnë ende aty janë njerëz me halle plot, punojnë e shpeshherë nuk fitojnë as mundin e tyre. Sot që flasim produktet bujqësore në Divjakë shiten me çmime që disa prej tyre janë falimentuese për fermerin. Kostoja e prodhimit të këtyre produkteve ndërkohë përfshin: punimet e tokës, farërat e fidanët, benzinën e pompave ujitëse, që nuk kanë pushuar së punuari nga dita e mbjelljes së këtyre prodhimeve e deri sot, deri në ditën e shitjes, plehtrat kimike super të shtrenjta, punëtorët e paguar nga fermeri dhe ajo që nuk llogaritet kurrë, djersia e këtij të fundit familjarisht. Ku është shteti këtu? A ka ndonjë hallkë të këtij zinxhiri ku futet shteti? Asnjë, fatkeqësisht! Janë fermerë të lënë në mëshirë të fatit. Sot dëshpërimi po gjen ngushëllim përherë e më tepër në përdorimin masiv të drogave të forta, që me keqardhje dua ta them, është rritur në mënyrë të frikshme kohët e fundit në Divjakë. Edhe këtu shteti është totalisht i verbër. Divjakës, në fakt, i ka falur Zoti, mbi gjithçka natyrën. Laguna ka mbajtur për shekuj një pjesë dërrmuese të banorëve, ekonominë e tyre. Atyre iu premtua në fushatë "laguna e lirë" "laguna e tyre" dhe iu ofrua "laguna me dryn", "laguna e aneksuar", "laguna e monopolizuar" nga pushteti lokal. Sot peshkatarët tradicionalë, ata që peshkojnë për të mbajtur familjet e tyre, nuk lejohen të futen në park, përmes të cilit një pjesë e tyre kalojnë në lagunë. Pra, nuk u lejohet as futja në park. Kjo është shkelje e hapur e ligjit. Policia Kufitare e Divjakës, me në krye drejtuesin e saj, është kthyer në xhandar të pushtetit, e cila jo vetëm u ka ndaluar peshkatarëve futjen në park e në lagunë, por u ka konfiskuar mjetet e tyre të peshkimit në befasi, gjatë natës, pa asnjë lajmërim zyrtar. Theksoj se veprimet e Policisë Kufitare javët e fundit në Divjakë kanë qenë selektive, joprofesionale dhe me ngjyrimet e qarta politike, gjë që nuk është aspak e hijshme për uniformat e tyre. Një tjetër çështje që dua të trajtoj sot është ajo e taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila është 3% për ndërtimin e një banese nga çdo familje në Republikën e Shqipërisë, edhe në Divjakë. Sot për të ndërtuar një shtëpi banimi në Divjakë kostoja totale e lejes së ndërtimit llogaritet mesatarisht 8 milionë lekë të vjetra. Pra, një familje përpara se të llogarisë buxhetin për të ndërtuar banesën e një jete, duhet që 8 milionë lekë, me përafërsi, t'i heqë veç për lejen e ndërtimit. Kjo shifër, shoqëruar me burokracitë për marrjen e lejes, shpeshherë i shtyn këta banorë të ndërtojnë edhe pa leje. Nga shifra totale e përmendur 3% e vlerës së objektit i takon taksës së ndikimit në infrastrukturë. Ndërkohë, nga ana tjetër, ju vë në dijeni, të nderuar kolegë, veçanërisht juve të qarkut të Fierit, se javët e kaluara nga Bashkia e Divjakës është kërkuar me ngulm ulja e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 3% në 0,1%, për ndërtimin e parkut fotovoltaik të

Karavastasë. Kjo është miratuar tashmë nga këshilli bashkiak Divjakë, pas 3 mbledhjesh radhazi brenda 1 jave, për shkak të rezistencës dhe kundërshtisë së hasur nga këshilltarët e bashkisë ndaj këtij propozimi, theksoj, janë të gjithë të majtë, ju e dini. Shqetësimi që dua të ngre për paralelizëm është: pse ky favorizim, duke i hequr këto para nga buxheti i Bashkisë së Divjakës, kur askush nuk mendon për të lehtësuar familjet e thjeshta, familjet e reja, por jo vetëm, të cilat shtëpinë e kanë kursimin dhe investimin e një jete punë? Do të kërkoj që kjo ndjeshmëri e Bashkisë së Divjakës dhe e qeverisë shqiptare ndaj investitorëve të mëdhenj dhe oligarkëve të shprehej edhe ndaj familjeve të zakonshme shqiptare, të cilat i ndërtojnë me sakrificë shumë të madhe banesat e tyre dhe ne e dimë shumë mirë këtë. Në të kundërt dënoj klientelizmin e shprehur rëndom në çdo qelizë të këtij pushteti. Flasin këtu për një taksë, e cila familjet që duan të ndërtojnë i rëndon sa 30-fishi i investitorëve të miliona eurove. Ky veprim i Bashkisë së Divjakës u heq qytetarëve të saj rreth 1,8 milionë euro nga buxheti i bashkisë, që fare mirë do të përktheheshin në më shumë investime dhe shërbime për qytetarët e Divjakës. Shpresoj në një zgjidhje për të mirën e qytetarëve dhe jo të oligarkëve. Çështja tjetër që dua ta përmend patjetër, e cila është e freskët, e dy ditëve më parë, ka të bëjë me banorët e zonës, pra të fshatrave në të dyja anët e autostradës. Këta banorë të zonës Lushnjë - Fier u vunë përpara faktit të kryer, bllokimit të atij që njihet si "kryqëzimi i pushimi të shoferit". Ky kryqëzim, në fakt, ka shërbyer për dekada si lidhës i fshatrave në të dyja anët e kësaj autostrade, me qytetet e Lushnjës dhe të Fierit, që është jetik për të gjithë veprimtarinë ekonomike, shëndetësore të banorëve të këtyre zonave. Janë me mijëra banorë që jetojnë në të dyja anët e autostradës dhe që e shfrytëzojnë këtë kryqëzim. Do të kërkoj që veprime të tilla, të befta, të pallogaritura në koston ekonomike, që u faturohen banorëve, siç ishte bllokimi i këtij kryqëzimi, të marrin fund. Më vjen mirë që pati një reagim ndaj protestës dhe indinjatës së banorëve nga institucionet përgjegjëse. "Pushimi i shoferit" është pika ku lidhen me Lushnjën dhe Fierin prej dekadash, mijëra banorë të fshatrave si: Gradishtë, Mërtish, Gorica, Këmishtaj, Spoletë, Babunjë, Sopëz, Remas, Krutje, Allkaj e të tjerë. Janë me mijëra banorë dhe nuk mundet që në kushtet e karburantit të shtrenjtuar t'u ngarkojmë edhe 30 kilometra rrugë së paku shtesë për të shkuar në destinacion, kryesisht në qytet. Shpresoj në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje, sepse zgjidhja që u dha me heqjen e bllokuesit metalik konsiderohet një zgjidhje momentale, sepse kjo nuk mbron jetën e banorëve që kalojnë aty. Shpresoj në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje, duke ndërtuar mbikalimin, që të mbrohet jeta e qytetarëve, të shmangen aksidentet, por pa shtuar faturat ekonomike dhe kohën e udhëtimit. Ju falënderoj! (Duartrokijte) Më falni, kam edhe diçka, nëse kam kohë. Dua ta demonstroj atë çka thashë më lart, për ndryshimin me një propozim që iu kërkua në 3 mbledhje radhazi brenda një jave këshilltarëve të bashkisë. Është i njëjti këshill bashkiak, i cili në datën 20.02.2020 ka vendosur të miratojë taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimin e sistemeve fotovoltaike, në masën 3% të vlerës të investimit. Ky është vendimi i këshillit bashkiak. Pas një viti i njëjti këshill me këtë propozim i kërkohet të vendosë uljen e kësaj takse nga 3% në 0,1 %. Pra, është një dëshmi e qartë e sensitivitetit dhe ndjeshmërisë së kësaj qeveri ndaj oligarkëve, por jo ndaj familjeve të thjeshta dhe ndaj ekonomisë së thjeshtë të tyre. Faleminderit!